



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201802032/2**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda:** *Rekomandime lidhur me problematikat e dala nga inspektimi i kryer në Shtëpinë e të Moshuarve, Shkodër.*

**Drejtuar:** **Zj. Luneda SUFALI**  
**Drejtoreshë e Përgjithshme**  
**Shërbimi Social Shtetëror**

**TIRANË**

**Për dijeni:** **Z. Edmond EMINI**  
**Drejtor i Shtëpisë së të Moshuarve**

**SHKODËR**

***E nderuar zonja SUFALI,***

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, më datë 12.10.2018, ka inspektuar Shtëpinë e të Moshuarve, Shkodër

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "*Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.*

*Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise".*

Qëllimi i inspektimit ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2017 si dhe gjendja aktuale.

Ju bëjmë më dije se më datë 17.11.2017 është kryer inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër. Për problemet e konstatuara ju jemi drejtuar me rekomandime për marrjen e masave për:

- Fillimin e punimeve për fazën e dytë të projektit për rikonstruksionin e godinave.
- Shtimin në organikë me një psikolog, një shofer dhe gjetjen e mundësive për vendosjen e një automjeti.
- Shtim në organikë me roje objekti.
- Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psiqike në një qendër zhvillimi.
- Gjetjen e një zgjidhje për të monitoruar donacionet për produkte ushqimore, me qëllim që të mos përfshihen në kuotën ushqimore ditore.
- Rritjen e kuotës ushqimore ditore, minimalisht në 350 lekë.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, na u kthye përgjigja e mëposhtme:

- *Për rekomandimin nr.1*, ka filluar faza e dytë e punimeve për rikonstruksionin e godinave.
- *Për rekomandimin nr.2*, nuk është përcjellë shkresë për nevojën e një psikologu. Nuk ka makina dhe shofer në organikë, në zbatim të ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “*Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nënpunësit civilë*”.
- *Për rekomandimin nr.3*, është e drejtë e institucionit mbi prokurimin e shërbimit me roje objekti.
- *Për rekomandimin nr.4*, përsa i përket të moshuarve me probleme të shëndetit, trajtohen nga ana e mjekut dhe ekipit multidisiplinar të institucionit me terapi të veçanta mjekësore dhe sociale. Ndërsa në Qendrat e Zhvillimit pranohen persona me aftësi të kufizuara deri në moshë 21 vjeç.
- *Për rekomandimin nr.5*, do të merren masa që donacionet të jenë mbi kuotën ditore.
- *Për rekomandimin nr.6*, Shërbimi Social Shtetëror i ka dërguar shkresë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me propozimin mbi indeksimin e kuotës ushqimore për përfituesit në Institucionet e Përkujdesjes Shoqëror.

***Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se:***

1.Rekomandimi për fillimin e punimeve për fazën e dytë të projektit për rikonstruksionit të godinave, është zbatuar.

2.Rekomandimi për shtimin në organikë me një psikolog, një shofer dhe gjetjen e mundësive për vendosjen e një automjeti, nuk është realizuar.

3.Rekomandimi për shtim në organikë me roje objekti, është realizuar.

4.Rekomandimi për ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psikike në një qendër zhvillimi, nuk është realizuar

5. Rekomandimi për gjetjen e një zgjidhje për të monitoruar donacionet për produkte ushqimore, me qëllim që të mos përfshihen në kuotën ushqimore ditore, është realizuar.

6. Rekomandimi për rritjen e kuotës ushqimore ditore, minimalisht 350 lekë, është realizuar. Me Udhëzimin nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e koutave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale “, kuota ushqimore është caktuar në vlerën e 360 lekëve në ditë.

### ***Nga inspektimi i kryer, konstatuam si më poshtë:***

Në këtë Shtëpi të Moshuarish trajtohen 47 përfitues, nga të cilët 22 me probleme shëndetësore (të paaftë fizikisht) dhe të shëndetit mendor. Të moshuarit vijnë nga të gjitha rrethet e vendit. Duke qenë se kapaciteti i këtij institucioni është për 60 përfitues, pritëshin përfitues të tjerë për t’u sistemuar. Është kthyer një i moshuar në familjen e tij në muajin Maj 2018.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 24 të moshuar, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim.

Ka një plan individual shëndetësor për çdo të moshuar. Për ata të moshuar, cilët janë të sëmurë, janë hapur kartela mjekësore. Rekomandimet e mjekut, zbatohen nga kujdestarët, të cilët punojnë me tre turne.

Personeli përbëhet nga 23 punonjës. Kopjet e dosjeve të personelit mbahen në institucion, pasi dosjet origjinale ndodhen në Shërbimin Social Shtetëror. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër.

Vlerësimet e punës së personelit bëhen dy herë në vit, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror, ndërsa kopjet mbahen në institucion.

Stafi është trajnuar vetë nga drejtuesi i këtij institucioni, pasi prej gati dy vitesh nuk ka patur trajnime nga Shërbimi Social Shtetëror.

Me problemet psiko-sociale merret punonjësi social dhe kujdestari. Shërbimi mjekësor realizohet nga një mjek me kohë të pjesshme.

Nuk ka shërbim dentar, pasi ai është privat dhe ky shërbim nga të moshuarit kryhet me shpenzimet e tyre.

Për ruajtjen e objektit, ishin punësuar dy roje: roja private gjatë orarit 6.00-22.00 dhe roja e institucionit në oraret 22.00-6.00.

Sistemi i ngrohje-ftohjes realizohet me energji elektrike, Chillerr, të cilat ishin të vendosura në çdo dhomë. Pulti për komandën e ajrimit mbahej nga personeli, ndërsa pult për komandën e ngrohjes kishte në çdo dhomë.

Për përcaktimin e menisë javore dhe ditore merret mendimi i përfituesve, i nënshkruar edhe nga një i moshuar. Oraret e vakteve të ushqimit vendosen sipas dëshirës së të moshuarve. Ushqimi konsumohet vetëm në mencë. Nëpër dhoma pihet kafe dhe konsumohen fruta.

Në çdo kat të godinave janë të vendosura mjetet kundër zjarrit. Stafi është trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit si dhe trajnuar stafi për dhënien e ndihmës së shpejtë nga Kryqi Kuq. Janë vendosur shkallët e emergjences.

Furnizimi me artikujt hotelierikë është shumë i mirë, nuk ka probleme. Çdo i moshuar ka marrë dy komplete çarçafësh, batanije të reja, me garderrobë të re, të cilat janë të vendosura nëpër dollape të reja. Në lavanderi ishin të vendosura lavatriçe e tharëse industriale si dhe lavatriçet joindustriale, të cilat kanë qenë ekzistuese.

Dhomat e të moshuarve shume të pastra. Korridore të reja, të shtruara me tapet. Ballkonet e rikonstruara dhe dyert e tyre të reja, me rrjeta për mosfutjen e insekteve.

Në guzhinë janë të vendosur katër frigoriferë. Kampionet e ushqimit ruhen në frigorifer. Sobat e gatimit janë industriale, të përshtatshme për përballimin e gatimit për numrin të përfituesve.

Dhoma ku realizohen takimet e të moshuarve me të afërmit e tyre është e re.

Për arsyen e mbajtjes pastër dhe të rregullt të dhomave, është hapur një dritare në korridor, në murin e perbashkët të korridorit me lavanderinë, ku çdo i moshuar pas mbarimit të orarit të punës së punonjësve të lavanderisë, i hidhte rrobat e përdorura për t'u larë në vaskën e vendosur posacërisht për këtë qëllim.

Në bibliotekë ishin vendosur disa libra, për t'u pasuruar në vijimësi. Ka disa të moshuar që kanë dëshirë të lexojnë libra. Salla e ndenjes është shumë komode, me televizor, kënde ndenje dhe e sistemuar gjë që krijonte një ambjent relaksues për të moshuarit.

Në katin e dytë të Godinës nr.1, janë të sistemuar të moshuar të sëmurë me probleme të shëndetit mendor dhe të paafte fizikisht.

Ambjenti nga mbrapa sistemuar me mjedise ç'lodhëse, me tenda. Janë mbjellë pemë, bar, për të krijuar një ambjent me gjelbërim. Në këtë ambjent është përshtatur një kënd për tharjen e rrobave.

Shfrytëzohej edhe uji i pusit, pas analizave të bëra në laborator.

Monitorimi i standardeve bëhet çdo muaj nga Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social Shtetëror Shkodër, 2-3 herë në vit nga Shërbimi Social Shtetëror, nga Instituti Higjenes, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Perpos faktit që ka një kuti ankesash, të moshuarit nëse kanë probleme, ankohen drejtpërsëdrejti te drejtuesi i institucionit dhe më pas mblidhen për ta diskutuar me të moshuarit e tjerë.

Disa të moshuar kanë të afërm dhe vizitohen nga to. Ka një regjistër ku pasqyrohet takimi. Stafi mban kontakt telefonik me të afërmit e tyre për raste të problemeve shëndetësore.

Nga drejtuesi i institucionit organizohen shpesh takime me të moshuarit si për problemet e përditshme, ashtu edhe për ushqimet e oraret e vakteve. Organizohen aktivitete të ndryshme, festa zyrtare, festat fetare, ditëlindje etj.

Pas takimit të bërë me të moshuarit, ata shprehën konsideratën ndaj të gjithë stafit të institucionit. Ata u shprehën se janë të kënaqur nga shërbimet e ofruara dhe veçanërisht aktualisht me rikonstruksionin e godinave dhe ambjenteve rreth saj. Nuk paraqitën ankesa ndaj stafit.

Në këtë institucion pastërtia mbizotëronte kudo dhe stafi ishte në krye të detyrës, në dhënien e shërbimeve ndaj të moshuarve.

Përpos kushteve shumë të mira të jetesës pas rikonstruksionit, gjatë këtij inspektimi, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

- Probleme shfaqen për personat me aftësi të kufizuar. Ata kanë nevojë për paketën higjieno-sanitare, pampersa. Për mbajtjen e një higjienë personale, duhet t'u bëhet banjo dy herë në ditë.
- Kujdestarët, duke u marrë me punët ditore, kërkojnë shpesh nga kjo kategori e të moshuarve për dhënien e shërbimeve.
- Janë 10 kujdestarë, nga të cilët një kujdestar kryen edhe detyrën e mirëmbajtësit dhe një tjetër të magazinierit. Vetëm 8 kujdestarë merren me të moshuarit. Duke llogaritur edhe ditët e pushimit javor, festat zyrtare, leja vjetore apo kur punojnë në turnin e tretë (dy kujdestare dhe një sanitare) bëjnë një javë punë një javë pushim, nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme për të dhënë shërbime cilësore.
- Janë dy godina me dy kate sejcila, sipërreth 2100 m<sup>2</sup> vetëm si ndërtesë, pa shtuar sipërfaqen e madhe të oborrit dhe ambjentet e jashtme, e papërbalueshme vetëm me një sanitare në turn.
- Tenderi i ushqimit, i detergjenteve, veshmbathje bëhet një herë në vit. Problemi qëndron në faktin se nuk furnizohen me detergjentet e kërkuara, sipas specifikës së këtyre llojve institucionesh. Tenderimi i drejtpërdrejtë është problem, pasi brenda ofertës vjen produkti jo cilësor.
- Në organikën e punonjësve të qendrës nuk ka psikologë, tepër e rëndësishme për kategorinë e të moshuarve që e kanë të nevojshëm praninë e një psikologu në këto institucione.
- Një problematikë që haset jo vetë në këtë institucion, por në të gjitha qendrat e përkujdesjes sociale, është çështja e shërbimit dentar. Ky shërbim mbulohet nga vetë të moshuarit. Do të sugjerohet që të një pjesë e këtij shërbimi të rimbursohet nga shteti.
- Në këtë institucion, siç u shprehëm më lart strehohen 22 të moshuar, të cilët janë me probleme shëndetësore dhe të shëndetit mendor, gjë që bëhet pengesë për një jetesë normale të të moshuarve të tjerë.

- Një problem shqetësues që ende ka mbetur pa i dhënë zgjidhje, është edhe ajo e mungesës së automjetit. Nuk ka përse të jenë në pritje të donacioneve, por vetë qendra duhet të ketë automjetin e saj për shumë shërbime të nevojshme për të moshuarit.

Sa më lart, për t'iu përgjigjur sa më shumë nevojave të personave përfitues në këtë institucion dhe për të plotësuar një nga standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale për të moshuarit, siç është pasurimi i rritit të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së tyre, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

## **REKOMANDOJMË**

Marrjen e masave për :

1. Shtimin në organikë me një psikolog ose animator social, të paktën dy kujdestarë, sanitare dhe një ndihmës kuzhinier.
2. Zëvendësimi i krevateve ekzistuese me të reja, të pështatura për të moshuarit, të cilët janë me probleme shëndetësore
3. Vendosjen e një automjeti.
4. Organizimi i trajnimeve në vijimësi të stafit.
5. Ngritjen një qendre socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, ku thuhet se, *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj rekomandimeve .

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R**

**Ermir KAPEDANI**

Konc.M.Morina  
Dt.13.02.2019